
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data: 30/07/2026

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i procedurës: “Blerje kostume për Ansamblin Popullor” për TKOBAP.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): Veshje të veçanta dhe aksesorë-18400000-3

Vlera e fondit limit: 16,604,500 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e katër mijë e pesëqind) lekë pa TVSH ose 177,455.38 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e tetë) euro pa TVSH

Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 30/07/2026 është 93.57 (nëntëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e shtatë) euro

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimi/ kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”* dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: *“3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit, është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :a)*

dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

Në rastin konkret Njësia e Prokurimit ka konsideruar te arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së fondit limit të lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontrates për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlere është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumnin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nëni 40 pika 3 dhe 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. përcaktohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se:

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme cka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë te Autoritetit

Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshme dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar në vlerën jo më pak se në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.Operatori ekonomik, në rast se është prodhues, për realizimin e objektit të prokurimit duhet të disponojë stafin me kualifikimet si më poshtë:

Minimalisht 1 (një) inxhinier tekstili/ teknik i lartë tekstili në rast se është prodhues (atelier) vërtetuar me:

-kontratën individuale të punës (të vlefshme);

-diplomën/ certifikimin/deshmine që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm

Minimalisht 2(dy) Punonjes artizanë përthurje veshjesh/ rrobaqepës/qepës tekstilesh/ekuivalent vërtetuar me:

-kontratën individuale të punës (të vlefshme);

-diplomë/dëshmi/certifikimin që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

Shenim: Kriteri nr.2.3.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar në të cilën përcaktohet : 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Kjo kërkesë është vendosur duke u referuar gjithashtu në nenin 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë prodhues të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Arsyetimi i rëndësisë së profesioneve të zgjedhura:

- 1 (një) inxhinier tekstili/ teknik i lartë tekstili

Për shkak të specifikës së lartë të objektit të prokurimit (Veshje Popullore), i cili kërkon njohuri të thelluara mbi densitetin e materialeve tekstile, programimin e makinerive të qëndisjes kompjuterike me fije ari/argjendi dhe ruajtjen e autenticitetit etnografik të prerjeve, OE duhet të disponojë në staf 1 (një) Inxhinier Tekstili ose Teknik të Lartë Tekstili, i cili do të mbikëqyrë procesin e modelimit, qëndisjes dhe kontrollit të cilësisë së kostumeve."Prodhimi i kostumeve kombëtare kërkon saktësi historike, materiale specifike dhe teknika komplekse që lidhen me trashëgiminë kulturore.

-2(dy) Punonjes artizanë përthurje veshjesh/ rrobaqepës/qepës tekstilësh/ekuivalent

Për shkak të specifikës të veçantë që mbart realizimi i veshjeve popullore (tradicionale), Autoriteti Kontraktor kërkon që Operatori Ekonomik të ketë në staf të paktën 2 (dy) Punonjës artizanë përthurje veshjesh / rrobaqepës / qepës tekstilësh ose ekuivalent, të cilët zotërojnë aftësi specifike në përpunimin manual dhe mekanik të kostumeve kombëtare. *Ky numër punonjësish është minimale që operatori ekonomik ofertues, duhet të kenë për zbatimin e kontratës. Kjo krijon bindjen e Autoritetit kontraktor se operatori ekonomik duke patur një staf të kualifikuar, garanton produkte përfundimtare cilësor, të qëndrueshme dhe jetëgjatë, të punuara në përputhje të plotë me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.*

3.Operatori ekonomik, në rast se nuk është prodhues i veshjeve popullore, duhet të dorëzojë një dokument (autorizim / kontratë furnizimi/akt-marrëveshje ose çdo dokument tjetër) që vërteton se ka një marrëveshje me një prodhues ose distributor zyrtar të veshjeve popullore. Në rast se dokumenti është nga distributori zyrtar duhet të bëhet lidhja e tij me prodhuesin e veshjeve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Kërkesa që Operatori Ekonomik jo-prodhues të dorëzojë një autorizim prodhuesi, kontratë furnizimi ose akt-marrëveshje, si dhe vërtetimin e lidhjes zinxhir midis distributorit dhe prodhuesit është në përputhje të plotë me parimin e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe barazisë së trajtimit, pasi nuk kufizon pjesëmarrjen e kompanive tregtare (jo-prodhuese), por garanton se ato disponojnë burimet e nevojshme teknike të palëve të treta në përputhje me konceptin ligjor të "mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera". Detajimi i lidhjes juridike midis distributorit dhe prodhuesit është i domosdoshëm për të provuar disponueshmërinë reale dhe legjitimitet të mallit (veshjeve popullore) gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kontratës duke garantuar se Autoriteti Kontraktor do të furnizohet me produkte që plotësojnë standardet e origjinës dhe certifikimit të kërkuar nga kuadri ligjor në fuqi. Përmes këtij mekanizmi ligjor, sigurohet që operatori fitues ka marrëdhënie të vërtetueshme kontraktuale me prodhuesin, gjë që minimizon rrezikun e dështimit të prokurimit dhe garanton ekzekutimin e sigurt të kontratës publike pa cenuar konkurrencën e lirë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të LPP, si dhe nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga specialisti i fushës etnografe dhe studiuese e trashëgimisë kulturore shqiptare dhe grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

➤ **Specifikimet teknike janë përcaktuar përfundimisht nga specialisti i fushës etnografe dhe studiuese e trashëgimisë kulturore shqiptare.**

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Sa më lart në të dhëna tabelare:

Nr.	Emërtimi	Specifikimet teknike	Njësia	Sasia
VERIU				
VERIU — BURRAT (Shiko vëllimet 3 – 4)				
1	Kostumi i burrave të Malësisë së Madhe — (11 palë)			

1.1	Opinga	Opinga e Tropojës e punuar përsipër me grep, me ngjyrë të bardhë	palë	11
1.2	Çorape	Çorape të Malësisë së Madhe / Malësisë së Gjakovës, të bardha, me model.	palë	11
1.3	Tirq	Tirq tipikë të Malësisë së Madhe me shumë zbukurime me gajtana të zinj, të qëndisur sipas dizenjove të modeleve të vjetra	copë	11
1.4	Tirq	Tirq për vallen “Festë e Madhe”, kafe e errët si vishnje e errët, me gajtana të zinj	copë	11
1.5	Brez	Brezi klasik i veriut, i punuar në tezgjah me vija të bardha, të zeza, jeshile e thellë dhe vishnje, material pambuku	copë	11
1.6	Brez	Brez lahore / mëndafshi me kuadrate	copë	11
1.7	Këmishë	Këmisha e Malësisë së Madhe / Tropojës / Pukës / Rugovës është me mëngë të ngushta, me pak rrudha tek supi, me manshetë të ngushtë; jakë ushtari. E çarë në formën e T-së tek gjoksi, që përfundon në mes të gjoksit me një kuadrat të zbukuruar me qëndisje në formë zig-zake, me ngjyrë bezhë; i njëjti zbukurim është edhe tek jaka.	copë	11
1.8	Jelek	Jeleku i Malësisë së Madhe si tek “Vallja e Shqipeve”	copë	11
1.9	Jelek	Jeleku i Malësisë së Madhe si tek vallja “Festë e Madhe”	copë	11
1.10	Qeleshe	Plisi i Kosovës, më i lartë se i Tropojës dhe pak më i fryrë, i prerë sipas modelit të vjetër	copë	11
2	Kostumi i burrave të Tropojës — (11 palë)			
2.1	Opinga	Opinga e Tropojës e punuar përsipër me grep, me ngjyrë të bardhë	palë	11
2.2	Çorape	Çorape të Malësisë së Madhe / Malësisë së Gjakovës, të bardha, me model	palë	11
2.3	Tirq	Tirq të Tropojës / Malësisë së Gjakovës, të prera sipas modelit të vjetër, me gajtana të zinj	copë	11
2.4	Brez	Brezi klasik i veriut, i punuar në tezgjah me vija të bardha, të zeza, jeshile e thellë dhe vishnje. Material pambuku.	copë	11
2.5	Këmishë	Këmisha e Malësisë së Madhe / Tropojës / Pukës / Rugovës është me mëngë të ngushta, me pak rrudha tek supi, me manshetë të ngushtë; jakë ushtari. E çarë në formën e T-së tek gjoksi, që përfundon në mes të gjoksit me një kuadrat të zbukuruar me qëndisje në formë zig-zake, me ngjyrë bezhë; i njëjti zbukurim është edhe tek jaka.	copë	11
2.6	Jelek	Jeleku i Tropojës	copë	11
2.7	Jelek	Jeleku i Rugovës së bashku me mëngore, me shajak të bardhë, i dekoruar me gajtana të zinj	copë	11
2.8	Qeleshe	Gjysmë sferike / plisi i bardhë i Tropojës, i shkurtër.	copë	11
3	Kostumi i burrave të Lumës — (10 palë)			
3.1	Opinga	Opingat e Korabit (Lumë, Dibër, Mat)	palë	10
3.2	Çorape	Çorapet e Lumës, me sfond të zi dhe të zbukuruar me lule tek kyçi i këmbës	palë	10
3.3	Tirq	Tirq tipikë të Lumës, të prera sipas dizenjove të modeleve të vjetra	copë	10
3.4	Brez	Brezi i Lumës, i bardhë me të zi dhe kuadrate	copë	10

3.5	Këmishë	Këmisha e Lumës dhe e Dibrës, me mëngë të ngushta si e Malësisë së Madhe, por pa zbukurimin	copë	10
3.6	Jelek	Kaporane e Lumës, me mëngë të shkurtra, e zezë, me jakë marinari	copë	10
3.7	Qeleshe	Qeleshe e Lumës, rrashatake cilindrike e shkurtër	copë	10
4	Kostumi i burrave të Dibrës — (10 palë)			
4.1	Opinga	Opingë specifike e veriut për vallen e Dibrës, me majë të rrumbullakët që krijon mundësinë e qëndrimit në majë të gishtave të valltarit	palë	10
4.2	Çorape	Çorapet e Dibrës, me sfond të zi dhe të zbukuruar me lule tek kyçi i këmbës	palë	10
4.3	Çorape	Çorapet e Mirditës, Matit dhe Kurbinit janë çorape të shkurtra me motive shumëngjyrëshe	palë	10
4.4	Tirq	Tirq tipik të Dibrës, të prera sipas dizenjove të modeleve të vjetra	copë	10
4.5	Brez	Brezi i Dibrës dhe i Matit, i bardhë me të zi dhe kuadrate	copë	10
4.6	Këmishë	Këmisha me mëngë të gjera si tek vallja “Në Garë”	copë	10
4.7	Jelek	Jeleku i Dibrës / Matit	copë	10
4.8	Jelek	Jeleku i Kurbinit / Lezhës / Mirditës	copë	10
4.9	Qeleshe	Qeleshe e Dibrës, Matit, Kurbinit dhe Mirditës, rrashatake cilindrike, por pak më të larta se e Lumës	copë	10
VERIU — GRATË (Shiko vëllimet 3 – 4)				
5	Kostumi i grave të Zerqanit (për te vallja e Shqipeve) — (11 palë)			
5.1	Opinga	Opinga Zerqani, të bardha, si tek Vallja e Shqipeve [edhe Mati i përdor].	palë	11
5.2	Çorape	Çorape të bardha që vijnë deri poshtë gjurit	palë	11
5.3	Tlinat (brekë)	Të gjata deri tek pulpa, të bardha, kambrik.	copë	11
5.4	Brez	Brez i nuseve të Zerqanit, të cilin e lidhin në mes.	copë	11
5.5	Këmishë	Këmishë e njëjtë me atë të xhubletës, por e shoqëruar me fund me rrudha, e cila vishet tek Zerqani.	copë	11
5.6	Përparje	Përparjet e Zerqanit janë me përmasa mesatare, me sfond të zi, të zbukuruar me vija të bardha në drejtim horizontal.	copë	11
5.7	Jelek	Jelege me mëngë të gjata të Zerqanit, me pëlhurë mëndafshi të trashë, të zbukuruar me vija horizontale, ngjyrë të kuqe, të verdhë dhe të zeza, e qëndisur me gajtan ngjyrë të zezë.	copë	11
5.8	Jelek	Xhybe e zezë treçerekshe me gajtana të kuq	copë	11
5.9	Mbuloja e kokës	Shamia si e xhubletës. Shami e leshtë, e zbukuruar me lule të stampuara shumëngjyrëshe. Ky variant përdoret edhe tek kostumi i Tropojës me kanac dhe në Zerqan. Ky variant mund të përdoret edhe tek kostumi i plotë me xhubletë.	copë	11
5.10	Zbukurime	Gjerdan gjoksi (zinxhir gjoksi) me para të mëdha për veshjen te Zerqanit dhe të Mirditës.	copë	11
6	Kostumi i grave të Mirditës, Matit — (10 palë)			
6.1	Opinga	Opinga si të Zerqanit, të bardha, si tek Vallja e Shqipeve [edhe Mati i përdor].	palë	10
6.2	Çorape	Çorape me sfond në ngjyrë vishnje të errët, zbukuruar me motive shumëngjyrëshe.	palë	10

6.3	Tlinat (brekë)	Për Kurbin, Mat, Mirditë, janë të gjera dhe deri tek kocka e kyçit të këmbës poshtë, ku edhe mblidhen.	copë	10
6.4	Brez	Brez i gjerë i Matit me sfond të kuq me kuadrata dhe vija të bardha.	copë	10
6.5	Brez	Brez i gjerë i Kurbinit, me shumë zbukurime me temina dhe rruaza.	copë	10
6.6	Këmishë	E njëjta këmishë si e Zerqanit si stilim, por fundi më i gjatë se tek Zerqani; janë këmisha për Matin.	copë	10
6.7	Këmishë	Modeli është i njëjtë me të Matit, por bluzja është shumë e dekoruar tek mënga dhe tek gryka; kjo është e Kurbinit.	copë	10
6.8	Këmishë	Po i njëjti model si i Matit si stilim (fund edhe bluzë), por pjesa e përparme e bluzës e modeluar me paleza të vogla, shoqëruar me kopsa me ngjyra. Kjo për Mirditën.	copë	10
6.9	Përparje	Përparjet e Burrelit janë në përmasa më të mëdha, me pëlhurë pambuku, me pak pala në pjesën e brezit, të zbukuruar me breza me ngjyrë të kuqe, portokalli, blu, të vendosura në drejtim vertikal.	copë	10
6.10	Përparje	I njëjti model me të Burrelit në stilim, por të zbukuruar edhe me motive të ndryshme të vendosura në drejtim vertikal, me disa ngjyra, janë përparjet e Kurbinit.	copë	10
6.11	Përparje	Përparjet e Mirditës janë në përmasa të vogla dhe të shoqëruara me thekë të gjata në të tre anët e saj.	copë	10
6.12	Jelek	Jeleku i Matit prej cohë të kuqe të mbyllur, zbukuruar me gajtan ngjyrë ari.	copë	10
6.13	Jelek	Jeleku i Kurbinit është me jakë të rrumbullakët, i ngjashëm me atë të Shqipërisë së Mesme, i zbukuruar me rruaza të bardha dhe temina shumëngjyrëshe.	copë	10
6.14	Mbuloja e kokës	Mbuloja e kokës së Macukullit (Mati). Referoju vëllimit 3 tek Veshjet popullore. (Vëllimi 3.)	copë	10
6.15	Mbuloja e kokës	Mbuloja e kokës së Kurbinit; po ashtu, për detaje, referoju tek vëllimi 4, Veshje popullore.	copë	10
6.16	Mbuloja e kokës	Mbuloja e kokës së Mirditës. (Vëllimi 4.)	copë	10
6.17	Zbukurime	Gjerdan gjoksi (zinxhir gjoksi) me para të mëdha ngjyrë argjendi, për veshjen e Zerqanit dhe të Mirditës.	copë	10
7	Kostumi i grave të Tropojës — (11 palë)			
7.1	Opinga	Opingat e Tropojës të punuara përsipër me grep, me ngjyra.	palë	11
7.2	Çorape	Çorape me fije leshi të punuara me shtiza, njëngjyrëshe, ngjyrë vishnje të errët, të gjelbërta të errëta ose blu, anësore të qëndisura.	palë	11
7.3	Tlinat (brekë)	Tlina treçerekshë të Zerqanit dhe Tropojës.	copë	11
7.4	Brez	Brez i Tropojës, i ngushtë, i qëndisur me punëkryq; e ka edhe Puka të njëjtë, Rugova, Hasi e Malësia e Gjakovës.	copë	11
7.5	Këmishë	Këmisha e Tropojës, varianti i parë, për kostumin me kanac (fund me pala të vogla). Kjo këmishë është e gjatë deri tek kofsha, bëhet me pëlhurë të trashë pambuku, e dekoruar me vija për së gjati, ngjyrë bezhë, e zbukuruar me qëndisje me motive të zonës, sistem dekorativ asimetrik. Mëngët janë të gjera dhe të gjata deri në bërryl, gjithashtu të zbukuruar me sistem asimetrik dhe me	copë	11

		dantellë të punuar me grep në fund të mëngës. (Për vallen në UNESCO.) Këto këmisha shoqërohen me krahca.		
7.6	Këmishë	Këmishë, varianti i dytë i Tropojës, si modeli i parë, por e gjatë deri në pulpat e këmbës; është këmisha e kostumit të Malësisë së Gjakovës (për në vallen “Festë e Madhe”). Këto këmisha shoqërohen me krahca.	copë	11
7.7	Fund (kanac)	Kanac i Tropojës, prej pëlhere të hollë leshi, i punuar në vegj, me pala të vogla, me ngjyrë të gjelbër të errët, ngjyrë të purpurt dhe me ngjyrë të kuqe të mbyllur (ngjyrë gjaku); pjesa fundore e zbukuruar me dantellë të bardhë. Gjithashtu në sipërfaqe ka edhe zbukurime floreale me rruaza shumëngjyrëshe. Kanaci shoqërohet me shamia të zbukurara me motive floreale në të dy pjesët anësore të trupit, si dhe në pjesën përpara, i palosur në formë trekëndëshi. Shamia përpara preferohet në ngjyrë të verdhë.	copë	11
7.8	Krahca	Krahcat janë gjysmë mëngë që vijnë të gjata nga bërryli deri në kyçin e dorës. Punohen me grep ose me shtiza, me fije të trasha pambuku, dhe zbukurohen me motive në formë gjetesh. Preferohen në ngjyrë të verdhë ose vishnje.	palë	11
7.9	Përparje	Futat (përparjet) e Malësisë së Gjakovës. Janë prej stofi të hollë; përpara më e madhe dhe e pasmjë më e vogël.	copë	11
7.10	Jelek	Jeleku i Tropojës, i cili përdoret edhe tek veshja me kanac dhe me futa, është i bërë me cohë (lloj stofi i hollë), zbukuruar me gajtan me ngjyrë të gjelbër, të verdhë, vishnje etj. dhe me motive unike të zonës.	copë	11
7.11	Jelek	Jeleku i Malësisë së Gjakovës, blu në gri (si tek vallja “Festë e Madhe”) dhe jeshile të errët.	copë	11
7.12	Mbuloja e kokës	Mbuloja e kokës e Malësisë së Gjakovës përbëhet nga një lloj shalli i gjatë dhe i ngushtë, në ngjyrë të bardhë, zbukuruar në dy ekstremet me motive gjeometrike. (Si tek vallja “Festë e Madhe”).	copë	11
7.13	Mbuloja e kokës	Shami koke, material pëlhere e qëndisur sipas modelit të vjetër.	copë	11
7.14	Zbukurime	Gjerdan me para më të vogla, që mund të përdoren për të gjitha kostumet e tjera.	copë	11

SHQIPËRIA E MESME

SHQIPËRIA E MESME — BURRAT (Shiko vëllimin 3)

8	Kostumi i burrave të Tiranës, Elbasanit dhe Durrësit — (10 palë)			
8.1	Opinga	Opingat klasike, pjesa e sipërme ngjyrë qumështi, prej lëkure. Tiranë, Elbasan, Kavajë, Krujë, Durrës etj.	palë	10
8.2	Çorape	Të bardha, me lule të kuqe, të verdha, jeshile tek kyçi i këmbës.	palë	10
8.3	Çorape	Të kuqe të errëta, të zbukurara me motive të vendosura në drejtim horizontal.	palë	10
8.4	Brekushe	Brekushet duhet të jenë në ngjyrë pana, pëlhurë e hollë e leshtë.	copë	10
8.5	Brekushe	Si dhe brekushet e dyta duhet të jenë në ngjyrë të zezë, pëlhurë e hollë e leshtë.	copë	10

8.6	Brez	Brezi klasik me ngjyra, me vija të bardha, të zeza, të verdha, jeshile e thellë dhe vishnje.	copë	10
8.7	Këmishë	Këmisha me mëngët e ngushta tek manshetat, por të gjera tek krahët e tek supet. Me jakën (T) dhe e çarë deri tek gropa e gjoksit; aty, në fund të të çarës, një kuadrat i vogël përforcues.	copë	10
8.8	Jelek	Me material stof të hollë, i kuq bojë gjaku, i stiluar me tre cepa përpara dhe zbukuruar me gajtan të zi dhe ngjyrë ari. Në variantin e burrave të veshur me jelek, janë të shoqëruar edhe me një shall të kuq me motive floreale.	copë	10
8.9	Jelek	Xhokë e zezë, prej materiali stofi, me mëngë deri në bërryl dhe jakë marinari që varet nga prapa. Pjesa e mëngëve, pjesët anësore të jakës, si dhe pjesa e përparme, janë të zbukuruara me tufçe rumbullake me të njëjtën ngjyrë.	copë	10
8.10	Jelek	Varianti i veshjes së Malësisë së Tiranës. Shëngjergj, Shupal etj. Kanë jelek me ngjyrë vishnje, me zbukurime me gajtane në ngjyrë ari në pjesën e përparme, por edhe pjesa e pasme pjesërisht është e zbukuruar.	copë	10
8.11	Qeleshe	Qeleshe të larta, në formë konike, me maje të prerë. (Referoju tek vëllimi 3.)	copë	10
8.12	Qeleshe	Qeleshe e zonave malore të Elbasanit, e cila është pak më e shkurtër se e para.	copë	10
9	Kostumi i burrave të Librazhdit (Rrajcës) — (11 palë)			
9.1	Opinga	Opingat klasike, pjesa e sipërme ngjyrë qumështi, prej lëkure. Tiranë, Elbasan, Kavajë, Krujë, Durrës etj.	palë	11
9.2	Jelek	Stof me ngjyrë natyrale të leshit, ashtu si tirqit, me gajtana të zinj. (Shiko vëllimin nr. 3.)	copë	11
SHQIPËRIA E MESME — GRATË (Shiko vëllimin 3)				
10	Kostumi i grave të Malësisë së Tiranës — (9 palë)			
10.1	Opinga	Opinga klasike, ngjyrë qumështi. Anash dhe në majë, të zbukuruara me tufçe fijesh shumëngjyrëshe, të ngjashme me ato të çorapeve.	palë	9
10.2	Çorape	Çorape të leshta me motive shumëngjyrëshe, ku dominon e verdha në nuancë portokalli dhe e kuqja.	palë	9
10.3	Breksha	Në veshjen e Malësisë së Tiranës përdoren brekushe të bardha pambuku, të gjata deri në kyçin e këmbës.	copë	9
10.4	Këmishë	Këmisha e grave të Malësisë së Tiranës përbëhet nga dy pjesë. Një fund me shumë rrudha, i gjatë deri në fund të këmbëve. Pjesa e sipërme si këmishë e thjeshtë, me jakën T dhe me mansheta.	copë	9
10.5	Brez	Brez i gjerë, i endur në tezgjah, i zbukuruar me alternime vijash dhe kuadrate me ngjyrë të kuqe, të verdhë, edhe pak të bardhë; ose i kuq me vija të bardha.	copë	9
10.6	Përparje	Për Malësinë e Tiranës përdoren përparje të gjata, të zbukuruara me alternime vijash të vendosura në linjë horizontale. Vijat mund të jenë të kuqe, të verdha, të bardha.	copë	9
10.7	Përparje	Varianti i dytë, e gjelbër e errët, vishnje, e bardhë dhe me fije metalike ngjyrë ari.	copë	9

10.8	Jelek	Jeleket e grave të malësisë janë me copë stofi ngjyrë vishnje, të zbukuruar me fije gajtanesh ngjyrë ari, i cili vjen deri afër brezit. Pjesë shoqëruese e jelekut të përshkruar në fillim është edhe një xhokë prej stofi të leshtë, ngjyrë pana, e zbukuruar në të gjitha pjesët anësore me gajtan, bërë me fije të trasha ngjyrë të kuqe, të verdhë dhe të gjelbër.	copë	9
10.9	Mbuloja e kokës	Shami e bardhë prej pëlhere pambuku, e qëndisur në të katër cepat me fije metalike ngjyrë ari ose argjendi. (Për veshjen e Malësisë së Tiranës.)	copë	9
10.10	Stolitë e qafës	Për veshjet e Malësisë së Tiranës, gjerdan gjoksi me të paktën tre vargje, të shoqëruara me monedha metalike ngjyrë argjendi.	copë	9
11	Kostumi qytetar i grave të Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit — (10 palë)			
11.1	Opinga	Këpucë të bardha me pak takë, me një rrip sipër. (Për Tiranën.)	palë	10
11.2	Opinga	Këpucë ngjyrë vishnje, me copë si kadife apo si stof, të qëndisura me motive floreale shumëngjyrëshe. (Për Elbasanin.)	palë	10
11.3	Çorape	Çorape për gratë e qytetit janë të bardha pambuku, pa asnjë zbukurim.	palë	10
11.4	Brekesh / Fundi	Për veshjen qytetare, brekushet janë të gjata deri poshtë gjurit.	copë	10
11.5	Brekesh / Fundi	Fund i gjerë, prej pëlhere të hollë, i cili vishet nën dimitë e mermerit.	copë	10
11.6	Këmishë	Këmisha e grave të qytetit të Tiranës dhe Durrësit bëhet me pëlhurë mëndafshi, e gjatë deri në kofshë, e stiluar me mëngë të gjera, shumë të qëndisura me fije ari dhe argjendi, dhe me një jakë të vogël të qëndisur.	copë	10
11.7	Këmishë	Këmishat e qytetit të Elbasanit janë të njëjta me variantin e mësipërm, por në pjesën e supit varet edhe një si spaletë e lëshuar, e zbukuruar njësoj si mëngët e këmishës.	copë	10
11.8	Përparje	Çervet e qytetit janë në formë katërkëndëshi, prej pëlhere transparente, të zbukuruar në të katër këndet e saj me fije metalike ngjyrë të verdhë ose argjendi.	copë	10
11.9	Dimitë	Dimi mermeri me këmbëza të qëndisura njësoj si jeleku i Tiranës.	copë	10
11.10	Dimitë	Dimi mermeri me këmbëza të qëndisura njësoj si jeleku i Elbasanit.	copë	10
11.11	Jelek	Jeleku klasik i Tiranës, prej stofi të hollë ose kadife, i qëndisur me fije metalike ngjyrë ari.	copë	10
11.12	Jelek	Jeleku klasik i Elbasanit, prej kadife të bardhë, i qëndisur me rruaza të bardha dhe fije metalike ngjyrë ari ose argjendi.	copë	10
11.13	Mbuloja e kokës	Kapele rrashatake shumë e shkurtër, prej kadife ngjyrë vishnje, njëlloj si jeleku i qëndisur, varianti i Tiranës.	copë	10
11.14	Mbuloja e kokës	Varianti i Elbasanit, e njëjta formë, por prej kadife të bardhë dhe po ashtu e qëndisur si jeleku.	copë	10
11.15	Stolitë e qafës	Rruaza të bardha për veshje me dimi mermeri. Për veshjet e Shqipërisë së Mesme dhe të qyteteve të tjera si Gjirokastra, Vlora dhe Çamëria.	copë	10

SHQIPËRIA E JUGUT				
SHQIPËRIA E JUGUT — BURRAT (Shiko vëllimet 1 – 2)				
12	Kostumi i burrave të Labërisë, Çamërisë dhe Toskërisë — (10 palë)			
12.1	Opinga	Opinga klasike të jugut, me xhufkë të kuqe dhe dyngjyrëshe, të kuqe dhe të zeza.	palë	10
12.2	Çorape	Çorape të bardha, mundësisht lesh i hollë, ose prej pambuku me fije të trasha.	palë	10
12.3	Kallce (gjunjare)	Kallcet të bardha të Labërisë. Fillojnë pak nën kockën e kyçit të këmbës deri nën gju. Pjesë e këtyre kallcave janë edhe lidhëset me tufçe. Stof i bardhë me gajtan të bardhë.	palë	10
12.4	Kallce (gjunjare)	Kallca të zbkuruar me motive si të jelekëve. (Përdoren Berat, Leskovik, Çamëri etj.)	palë	10
12.5	Kallce (gjunjare)	Shirit i kuq i errët me gajtan të zi në mes dhe me tufçe që lidhet tek gjuri.	copë	10
12.6	Benevrekë në formë streçe	Streçe baleti elastike, të bardha, të trasha. Këto hyjnë në kategorinë e kofshareve të veshjes tradicionale, por tashmë të përshtatura për valltarët.	copë	10
12.7	Fustanellë	Një lloj fundi i gjerë me shumë pala, i stiluar me pjesë të veçanta, i cili duhet të jetë i përshtatur për të kërcyer dhe i gjatë deri pak poshtë gjurit.	copë	10
12.8	Brez	Brez i bardhë me vija vertikale. (Përdoret për veshjet e Labërisë dhe të Çamërisë.)	copë	10
12.9	Këmishë	Këmisha të bardha, me mëngë të gjera, të hapura kryesisht për fustanellën. Me jakën T, të hapur deri tek gjoksi, e qëndisur tek jaka dhe hapja e gjoksit me fije të bardha. Pra, këmishë e bardhë e qëndisur me fije të bardha.	copë	10
12.10	Krahca	Mëngë të bardha me fije leshi në ngjyrë natyrale, por edhe pambuk të përshtatur me ngjyrën e leshit natyral.	palë	10
12.11	Jelek	Jeleku i Çamërisë, i shoqëruar me mëngore që varen të kapura pas. Bëhet me stof të zi dhe me qëndisje të shumta me fije që imitojnë gajtanat ngjyrë ari. (Shiko vëllimin 1.) Gjithashtu edhe qyteti i Gjirokastrës përdor po këtë jelek.	copë	10
12.12	Jelek	I njëjti jelek me mëngore, por stof i do të jetë me ngjyrë blu për Toskërinë. (Qëndisja, varianti i Toskërisë. Shiko vëllimin 2.)	copë	10
12.13	Qylaf	Qylaf me majë (me antenë), për Labërinë, Çamërinë.	copë	10
12.14	Qylaf	Qylaf në formë konike, me fund të prerë, me lartësi mesatare, për Toskërinë.	copë	10
12.15	Qylaf	Qylaf në formë varke (zarf) për veshje me poture si në Labëri dhe Toskëri.	copë	10
12.16	Gjoksore (stoli metalike)	Stoli metalike në formë rombi; në të katër cepat ka zinxhirë që kapen tek jelekët me kapse (me gremça). (Shiko vëllimin 1.)	copë	10
13	Kostumi i burrave të Myzeqesë — (10 palë)			
13.1	Poture	Poture të zeza të Myzeqesë do të përdoren edhe tek Labëria. Poturet janë lloj pantallonash të gjera që shkojnë deri nën gju dhe mbulohen nga kallcet. Pëlhurë leshi.	copë	10
13.2	Këmishë	Këmisha të bardha me prerje dhe qëndisjen si varianti më sipër, me mëngë jo shumë të gjera dhe të mbyllura tek kyçi i dorës. Si për Myzeqenë, ashtu edhe për Labërinë.	copë	10

13.3	Jelek	Jeleku i veshjes me poture për Myzeqenë dhe Labërinë bëhet me të njëjtin material si poturet, me ngjyrë të bardhë, i shoqëruar me mëngore, i qëndisur me fije kafe të hapur ose blu. (Shiko vëllimin 1, Rrethi i Vlorës.)	copë	10
13.4	Jelek	Jeleku i veshjes me poture për Labërinë, pa mëngë, bëhet me të njëjtin material si poturet, me ngjyrë të zezë, i qëndisur me fije të bardha. (Shiko vëllimin 1, Rrethi i Vlorës.)	copë	10
13.5	Qylaf	Takie Myzeqeje, të bardha, të qëndisura me fije të bardha.	copë	10
SHQIPËRIA E JUGUT — GRATË (Shiko vëllimet 1 – 2)				
14	Kostumi i grave të Dardhës — (10 palë)			
14.1	Këpucë	Këpucë të zeza me pak takë për Dardhën.	palë	10
14.2	Çorape	Çorape pambuku, të gjata deri në gju. Sfondi me ngjyrë vishnje, blu të errët, zbukuruar me vija në linjë horizontale me ngjyra të kuqe, të bardha, të gjelbra. (Për Dardhën.)	palë	10
14.3	Mbathje	Mbathjet e grave të Dardhës janë të bardha, pëlhurë pambuku. Të ngushta e të gjata deri poshtë gjurit dhe poshtë shoqërohen me një dantellë të bardhë.	copë	10
14.4	Fustan	Fustan i Dardhës, me mëngë të gjata, prej stofi ngjyrë vishnje të errët, pjesa fundore e të cilit stilohet me pala të mëdha. Fustani është i hapur përpara deri në bel dhe i zbukuruar në pjesën e gjoksit. Ky fustan shoqërohet me përparje dhe cibun të shënuara më poshtë. (Shiko vëllimin 2.)	copë	10
14.5	Cibun	Sipër fustanit ka edhe cibunin ngjyrë blu të errët (një lloj paltoje pa mëngë, shumë e hapur përpara), zbukuruar me gajtan ngjyrë vishnje. [Shiko vëllimin 2.]	copë	10
14.6	Përparje	Përparjet e Dardhës janë me të njëjtin material si fustani, të zbukuruara me gajtana të zinj. (Shiko vëllimin 2.)	copë	10
14.7	Këmishë	Varianti i Dardhës është një këmishë pambuku, ngjyrë pana, që shkon deri tek kofsha e këmbës; pjesa e përparme e hapur deri në gjysmën e gjoksit dhe e zbukuruar me dantellë po në ngjyrë pana. (Shiko vëllimin 2.)	copë	10
14.8	Mbuloja e kokës	Shamia e Dardhës, ngjyrë blu e errët ose vishnje e errët. (Vëllimi 2.)	copë	10
14.9	Zbukurime	Për zbukurimet e Dardhës shiko vëllimin 2.	copë	10
15	Kostumi i grave të Çamërisë me fund dhe me xhakëtë (sako) — (10 palë)			
15.1	Këpucë	Këpucë të kuqe të errëta, të qëndisura, me pak takë. (Vlorë, Gjirokastrë, Çamëri.)	palë	10
15.2	Këpucë	Këpucë ngjyrë të purpurt, të qëndisura, me pak takë, për Beratin.	palë	10
15.3	Çorape	Çorape të bardha pambuku. (Për Beratin, Gjirokastrën, Vlorën, Çamërinë.)	palë	10
15.4	Mbathje	Mbathje të bardha, pëlhurë pambuku. Të ngushta e të gjata deri poshtë gjurit dhe të zbukuruara poshtë me dantellë.	copë	10
15.5	Fund	Fundi prej stofi të hollë, ngjyrë vishnje, për gratë e Vlorës, Gjirokastrës. Për Çamërinë, ngjyrë blu. Të gjata deri tek pulpa e këmbës, të zbukuruara me qëndisje në pjesën	copë	10

		fundore. Fundi shoqërohet me një brez të qëndisur njësoj si pjesa fundore.		
15.6	Këmishë	Këmishë e bardhë prej mëndafshi, me mëngë të ngushta, e gjatë deri tek kofshët, e hapur deri tek gjoksi dhe e zbukuruar me dantellë.	copë	10
15.7	Xhaketë (sako)	Xhaketë (sako) me mëngë të gjata dhe e gjatë deri poshtë belit. (Shiko vëllimin 1.)	copë	10
15.8	Mbuloja e kokës	Shamija mëndafshi njëngjyrëshe në formë trekëndëshe. Lejla, bojë qielli ose rozë, të shoqëruara me ojna me ngjyra të ndryshme në të tre pjesët anësore të saj.	copë	10
16	Kostumi i grave të Çamërisë me tumane — (10 palë)			
16.1	Tumanet	Tumanet, lloj pantallonash shumë të gjera, me ngjyrë të kuqe, të qëndisura në pjesën e përparme dhe tek këmbët. (Çamëria.)	copë	10
16.2	Këmishë	Ky variant përdoret edhe me sako dhe me tumane. Këmishë e bardhë prej mëndafshi, me mëngë të gjera e të qëndisura me fije metalike, e gjatë deri tek kofshët, e hapur deri tek gjoksi dhe e zbukuruar me dantellë.	copë	10
16.3	Jelek	Jelek i Gjirokastrës, pa mëngë (Gjirokastër, Çamëri). (Vëllimi 1.)	copë	10
16.4	Mbuloja e kokës	Varianti i Gjirokastrës me tumane, një lloj feste e shoqëruar me zbukurime dhe fije metalike. (Shiko vëllimin 1.)	copë	10
17	Kostumi i grave të qytetit të Vlorës — (10 palë)			
17.1	Këmishë	Këmishë mëndafshi, me mëngë të gjera të qëndisura, dhe fundi i këmishës i qëndisur gjithashtu me disa vija të holla. E shoqëruar kjo këmishë edhe me një fund pëlhure të hollë pambuku. (Për vlonjaten me xhybe (pirpiri).)	copë	10
17.2	Jelek	Jelek i Gjirokastrës, pa mëngë (Gjirokastër, Vlorë, Çamëri). (Vëllimi 1.)	copë	10
17.3	Jelek	Xhybe (pirpiri), që përdoren në Vlorë dhe Gjirokastër. Një lloj palltoje pa mëngë, në ngjyrë vishnje, e zbukuruar me gajtan ngjyrë ari. (Shiko vëllimin 2.)	copë	10
17.4	Mbuloja e kokës	Varianti i Gjirokastrës, një lloj feste e shoqëruar me zbukurime dhe fije metalike. (Shiko vëllimin 1.)	copë	10
18	Kostumi i grave të Beratit — (10 palë)			
18.1	Këpucë	Këpucë ngjyrë të purpurt, të qëndisura, me pak takë, për Beratin.	palë	10
18.2	Fustan	Fustani i bardhë prej mëndafshi, i gjatë deri poshtë pulpave, i zbukuruar në pjesën fundore. Në pjesën e përparme të gjoksit gjithashtu i zbukuruar si në pjesën fundore dhe i shoqëruar me një dantellë të hollë në pjesën e qafës, e cila vjen paksa e hapur deri në gjoks. Ky lloj fustani ka mëngë të gjera, gjithashtu të zbukuruar. Ky fustan shoqërohet me një brez të ngushtë prej kadifeje, ngjyrë purpur, i qëndisur me fije ari, i shënuar më poshtë. Ky fustan gjithashtu shoqërohet me një fund të bardhë prej pëlhure të hollë prej pambuku, i shënuar më poshtë. (Ky është vetëm i Beratit.) (Shiko vëllimin 2, variantin e veshjes verore.)	copë	10

18.3	Brez	Brez i ngushtë kadifeje, i qëndisur me motive të ngjashme si të jelekut.	copë	10
18.4	Fund	Fundi prej pëlhure pambuku të hollë, të bardhë.	copë	10
18.5	Këmishë	Këmishë mëndafshi, me mëngë të gjera të qëndisura, dhe fundi i këmishës i qëndisur në pjesën fundore me motive floreale.	copë	10
18.6	Jelek	Jelek Berati, prej kadifeje ngjyrë të purpurt dhe me motive të stilit të Beratit. (Shiko variantin veror tek vëllimi 2.)	copë	10
18.7	Mbuloja e kokës	Feste e Beratit, një lloj kapeleje si në variantin e veshjes verore. (Vëllimi 2.)	copë	10
PJESË DHE VESHJE TË VEÇANTA				
19	Pjesë të veçanta			
19.1	Paruke	Paruke grash të modelit të Malësisë së Madhe për veshjen me xhubletë.	copë	12
19.2	Dollame	Dollame burri Kurbin. (Vëllimi 4.) Maksimumi.	copë	2
19.3	Jelek i gjatë pa mëngë	Jelek i gjatë pa mëngë, me lëkurë deleje me (gjithë leshin), Tropojë, M. Madhe.	copë	8
19.4	Pelerinë	Pelerinë e gjatë me ngjyrë të zezë, me fije leshi të tërhequra (Sharku i Bariut), Labëri. (Vëllimi 1, Vlora.)	copë	2
19.5	Pelerinë	Pelerinë Rugove	copë	3
19.6	Jelek	Jelege tipike të Malësisë së Tiranës, Shupal, Shëngjergj	copë	3
Këto të fundit do të vishen vetëm nga këngëtarët solistë.				
VESHJE TË PLOTA				
20	Veshje të plota			
	Veshje e plotë	Veshja me xhubletë, e shoqëruar me stolitë përkatëse, në tërësi duhet të shikohet me detaje në vëllimin 4, si dhe botimin e veçantë të titulluar “Xhubleta”.		
20.1	Kostumi i grave me xhubletë dhe pjesët përbërëse të saj — (11 palë)			
20.1.1	Xhubleta	Pjesë përbërëse e kostumit të grave me xhubletë.	copë	11
20.1.2	Kraholi	Pjesë përbërëse e kostumit të grave me xhubletë.	copë	11
20.1.3	Mëngëza	Pjesë përbërëse e kostumit të grave me xhubletë.	palë	11
20.1.4	Grykëza	Pjesë përbërëse e kostumit të grave me xhubletë.	copë	11
20.1.5	Kërdhokla	Pjesë përbërëse e kostumit të grave me xhubletë.	copë	11
20.1.6	Postava	Pjesë përbërëse e kostumit të grave me xhubletë.	copë	11
20.1.7	Pështjellaku	Pjesë përbërëse e kostumit të grave me xhubletë.	copë	11
20.1.8	Çorape prej leshi (“kallcet”)	Të xhubletës, të zeza; vijnë si të gjera, të zbukuruar me motive në ngjyrë vjollcë, të gjelbër dhe pak të verdhë me portokalli.	palë	11
20.1.9	Jeleku	Pjesë përbërëse e kostumit të grave me xhubletë.	copë	11
20.1.10	Shamia apo ruba e kokës	Shamia e xhubletës, varianti i parë. Tyl i bardhë, shoqëruar me një lloj kapele të vogël (kapicë), i zbukuruar me motive floreale. Ky variant është tek kostumi i plotë me xhubletë.	copë	11
20.1.11	Shamitë e mesit	Pjesë përbërëse e kostumit të grave me xhubletë.	copë	11
20.1.12	Kapica	Pjesë përbërëse e kostumit të grave me xhubletë.	copë	11
20.1.13	Stolitë dhe zbukurimet prej sermi	Stolitë dhe zbukurimet e xhubletës; referojuni vëllimit 4 tek Veshjet popullore.	copë	11

20.1.14	Këmisha e xhubletës	E cila është deri tek kofsha, e thjeshtë, me mëngë pak me rrudha tek supi e me mansheta dhe me grykë (jakë T) ushtari.	copë	11
20.2	Veshje e plotë	Veshja e Zadrimës, e shoqëruar me stolitë përkatëse, do të shikohet në variantin veror me detaje. Shiko vëllimin 4.	set	10
20.3	Veshje e plotë	Veshja e grave myzeqare me gunellë. (Vëllimi 1.)	set	10
20.4	Veshje e plotë	Kostumi i grave të Librazhdit (Rrajcës) duhet të jetë i plotë. (Shiko vëllimin nr. 2.)	set	11

➤ **Sqarim/orientim për OE:**

-OE-të duhet t’u referohen 5 (pesë) vëllimeve të quajtura “Veshje Popullore Shqiptare”, të botuara nga Akademia e Shkencave (Instituti i Antropologjisë) si dhe vëllimit “Xhubleta” me autore Afërdita Onuzi.

-Vëllimet janë botime të Akademisë së Shkencave (Instituti i Antropologjisë). Botimet mund të gjenden pranë këtij institucioni dhe informacioni rreth tyre mund të merret në linkun akad.gov.al

-Gjithashtu për lehtësi, bashkëlidhur DST-së gjeni fotot e kostumeve popullore objekt prokurimi. Garancia e mallrave objekt prokurimi:

-Garancia duhet të jetë jo më pak se 5 (pesë) vjet nga data e marrjes në dorëzim dhe nënshkrimit të procesverbalit të pranimit të të gjithë mallrave objekt prokurimi.

Garancia duhet të mbulojë riparimin dhe/ose zëvendësimin e pjesëve me defekt që rrjedhin nga aspekte prodhimi, materiali, punimi etj., gjatë përdorimit normal profesional të mallrave objekt prokurimi.

-Stolitë, si për burrat edhe për gratë, duhet të hiqen dhe vihen pa u qepur (me gremça)

-Masat për veshjet do të përcaktohen në momentin e nënshkrimit të kontratës

Argumentimi mbi garancinë:

Garancia duhet të mbulojë riparimin dhe/ose zëvendësimin e pjesëve me defekt që rrjedhin nga aspekte prodhimi, materiali, punimi etj., gjatë përdorimit normal profesional të mallrave objekt prokurimi. Garancia 5 (pesë) vjeçare është vendosur meqenëse mallrat objekt prokurimi janë të destinuara për përdorim skenik dhe sepse ndërtimi teknik i kostumeve duhet të parashikojë veshjen dhe zhveshjen e shpejtë, në mënyrë praktike dhe pa dëmtuar elementët përbërës gjatë ndërrimeve në skenë. Stolitë, si për burrat edhe për gratë, krahas origjinalitetit në forma, ngjyra etj., duhet të hiqen dhe vihen pa u qepur (me gremça).

Për të siguruar sa më lart cituar, nga komisioni *ad hoc* është vendosur kjo periudhë garancie meqenëse mallrat objekt prokurimi janë kostumet popullore të Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore të Republikës së Shqipërisë dhe nevojës për jetëgjatësinë e tyre ndër breza artistësh.

NJËSIA E PROKURIMIT